

Seanca Plenare

Seanca nr.2003/30

Prishtinë,më 30 tetor 2003,në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit Komunal të Prishtinës.

PROCESVERBAL

Seancën e kryesoi Nexhat **DACI**, kryetar i Kuvendit, kurse bashkëkryesues ishte Hydajet **Hyzeni**,anëtar i Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 99 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Në seancën e mëparshme ishte miratuar rendi i ditës i kësaj seance,si vijon:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme;
2. Shqyrtimi i parë P/ligjit kundër diskriminimit-nr.2003/28;
3. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit për inspektoratin sanitar-nr.2003/27;
4. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit për pensionet e aftësisë së kufizuar-nr2003/32;
5. Shqyrtimi i propozimit për formimin e grupit të punës për përgatitjen e propozimit për ndryshimin dhe plotësimin e Kornizës Kushtetuese dhe
6. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare të datës 6 nëntor 2003.

Kryetari propozoi që pikat 3 dhe 4 e rendit të ditës të shtyhen për seancën plenare të datës 6 nëntor 2003,ngase raportet dhe rekomandimet e komisioneve u janë shpërndar me

vonesë deputetve dhe nuk kanë pasur kohë t'i shqyrtojnë. Ai i bëri vërejtje disa komisioneve të Kuvendit që nuk po i shqyrtojnë P/ligjet dhe nuk po i raporojnë Kuvendit në afatin e paraparë.

Kuvendi e miratoi propozimin e kryetarit.

Berat Luzha, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, shprehu shqetësimin për provokimin e familjes Jashari në Prekaz nga KFOR-i francez, si dhe për burgosjen e pesë personave, ish ushtarë të UÇK-së, nga komuna e Kaçanikut, në bazë të dëshmive të konstruara nga policia serbe.

Ai kërkoi që Kuvendi të miratojë një deklaratë ose vendim për status të veçantë të familjes Jashari.

Kryetari tha se i përkrah shqetsimet e Berat Luzhës, por ky propozim, nuk është çështje e ngutshme, duhet të shqyrtohet në Kryesi. Ai theksoi se Kryesia e Kuvendit ka marë vendim dhe ka kërkuar nga Qeveria e Kosovës ta përgatisë P/ligjin për mbrojtjen e vlerave të luftës. Më e dobishme është që Kuvendi të miratojë ligjin për mbrojtjen e vlerave të luftës, se sa të miratojë ndonjë deklaratë.

Gani Koci tha se familjes Jashari, përveç përkrahjes morale, i duhet edhe mbrojtja institucionale nga organet e Kosovës. Ai ia paraqiti Kuvendit tekstin e vendimit për miratim. Kuvendi duhet ta ngarkojë Qeverinë e Kosovës, shtoi ai, ta përgatisë P/ligjin që familja Jashari të gëzojë status të veçantë dhe mbrojtje institucionale, si dhe Lagja e Jasharve të shpallet kompleks memorial, me emrin e komandantit legjendar Adem Jashari, si objekt i një rëndësie me vlera të veçanta historike.

Arsim Bajrami propozoi që grupet parlamentare, gjatë një pauze ta përgatisnin tekstin e deklaratës për çështjen e ngritur dhe t'ia propozojnë Kuvendit për miratim. Ai, në emër të Komisionit Legjislativ, shprehu gatishmërinë për hartimin e P/ligjit të veçantë për mbrojtjen e Kompleksit të Jasharajve.

Kryetari theksoi se nuk e konsideron propozimin e Grupit Parlamentar si çështje të ngutshme, për ta radhitur në rend dite të kësaj seance. Por, nëse ky grup insiston, shtoi ai, atë propozim mund ta hedhë në votim.

Ai kërkoi që seanca të vazhdojë punimet, sipas rendit të miratuar të ditës.

1. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme.

Procesverbali i seancës të mëparshme u miratua me vërejtjen e deputetit Sabri Hamiti, ngase ishte bërë lëshim në evidencimin e diskutimit të tij lidhur me P/ligjin për barazi gjonore.

2. Shqyrtimi i parë i P/ligjit kundër diskriminimit-nr.2003/28.

Kryetari e ftoi propozuesin e P/ligjit ta arsyetonte para deputetve të Kuvendit.

Kryeministri Bajram Rexhepi theksoi se ky Projektligj është përgatitur për një kohë relativisht të gjatë dhe puna rreth hartimit është koordinuar me ekspertë vendës dhe ndërkombëtar si dhe me përfaqësues të UNMIK-ut. Ligji është një pikë synim për pengimin e çfarëdo forme të diskriminimit për të gjithë kosovarët. Ky ligj është në pajtim me ligjet dhe standardet ekzistuese antidiskriminuese në nivelin evropian dhe ndërkombëtar dhe përmbushje e obligimeve të Kornizës Kushtetuese për institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes në Kosovë, sepse përmbush në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe thellësisht këto obligime.

P/ ligji është i bazuar në direktivën e Këshillit të Unionit Evropian 2000/43 lidhur me implementimin e parimit të trajtimit të barabartë të personave, pa dallim përkatësie racore e etnike. Mirëpo, duke mos qenë i kufizuar vetëm në diskriminimin mbi baza racore e etnike, ai është zgjeruar edhe në mbrojtjen e kategorive të tjera, si gjinisë, moshës, gjuhës, mendimit apo bindjes politike, përkatësisë kombëtare përkatësisht fetare, personave me aftësi të kufizuara e tjerë dhe i është përshtatur rrethanave dhe specifikave të Kosovës.

Ligji kundër diskriminimit do t'i mbrojë të gjithë personat fizik dhe juridik të sektorit publik dhe privat, pa dallim në fushën e punësimit, pagesës, largimit nga puna, anëtarësimin dhe përfshirjen në organizata të punëtorëve, mbrojtjen sociale, arsimimin, trajtimin e barabartë para organeve të drejtësisë dhe çdo të drejtë tjetër të paraparë me aktet në fuqi.

Karakteristikat e veçanta të këtij ligji mund të përmbledhin si vijon:

- Përkufizimet e kuptimeve të diskriminimit të drejtpërdrejtë dhe diskriminimit të tërthortë, ngacmimit, viktimizimit dhe segregacionit;
- Fushëveprimin e ligjit përkatësisht fushave ku ndalohet diskriminimi bashkë me masat afirmative;
- Rregullat lidhur me barrën e të provuarit në të cilat raste barra e të provuarit duhet të kalojë te pala e paditur me rastin e paraqitjeve të dëshmimeve kundër diskriminimit, me përjashtim të procedurave gjyqësore penale;
- Sanksionet e parapara, dënimet me gjobë dhe formimi i qendrës për trajtim të barabartë.

P/ligji bart edhe përparësinë e vet politike se si ta vendosë Kosovën në ballë të legjislacionit kundër diskriminimit, në Ballkan dhe Evropë dhe ky është një tregues i drejtpërdrejt, se me nxjerrjen e ligjit kundër diskriminimit Kosova, që në hapat e parë të përpilimit të legjislacionit vendor, po bën harmonizimin e plotë të akteve të veta juridike me legjislacionin evropian.

Kryeministri i ftoi deputetët e Kuvendit ta miratonin këtë P/ligj.

Kryrtari e hapi diskutimin lidhur me këtë P/ligj.

Zylfije Hundozi theksoi se ky P/ligj trajton në mënyrë të barabartë të gjithë qytetarët e Kosovës, duke mos lejuar diskriminimin e drejtpërdrejt apo të tërthortë të askujt.

Dispozitat e P/ligjit për Qendrën e trajtimit të barabart të qytetarve dhe raporti i saj me Ombduspersonin janë shtruar vetëm në mënyrë hipotetike. Gjatë procedurës së shqyrtimit, ky P/ligj duhet të plotësohet.

Grupi parlamentar i AAK-së, në parim, e përkrah këtë P/ligj.

Alush Gashi tha se Grupi Parlamentar i LDK-së, në parim e përkrah këtë P/ligj, por vërejtjet dhe sugjerimet e veta, do t'i paraqesë gjatë fazës së shqyrtimit të tij.

Arsim Bajrami tha se grupi parlamentar i PDK-së, në parim e përkrah këtë P/ligj. Krahas këtij P/ligji, Kuvendi duhet të miratohet edhe ligji për të drejtat e minoriteteve. Çështja e sansioneve nuk duhet të normohet në çdo ligj, por ajo përcaktohet me ligjin penal dhe me atë për kundërvajtje. Ai pati vërejtje në mënyrën e hartimit të tij, ku më shumë mbizotërojnë qëndrimet politike në vend të normave juridike.

Dragidha Krstoviq theksoi se Grupi parlamentar "Kthimi" nuk e përkrah këtë P/ligj, ngase sipas tyre, ky është vetëm një version i Kartës së OKB-së. P/ligji nuk është hartuar mirë dhe është i pazbatueshëm. Ai propozoi që t'i kthehet ky P/ligj Qeverisë dhe ajo të hatohet teksti i ri.

Faik Marolli theksoi se grupi Parlamentar i "komuniteteve të tjera" e përkrah këtë P/ligj, kurse vërejtjet dhe propozimet e veta do t'i paraqesin gjatë fazës së shqyrtimit të tij.

Sabri Hamiti theksoi se e përkrah në parim këtë P/ligj. Por, me miratimin e këtij p/ligji, shtoi ai, duhet të merret fund diskriminimi pozitiv ose negativ. P/ligji më shumë i përngjan një konvente për trajtimin e barabartë të qytetarve se sa një ligj, të cilin duhet përmirësuar gjatë fazës së amendamentimit.

Hydajet Hyseni tha se e përkrah, në parim, këtë P/ligj. Ai i bëri vërejtje dispozitave përfundimtare të p/ligjit, të cilat shtoi ai, duhet të përmirësohen gjatë fazës së amendamentimit.

Fatmir Sejdiu theksoi se porosia për Qeverinë është kjo: a) Tekstet e p/ligjeve nuk janë të harmonizuara në të tri gjuhët; b) Të mos krijohen dualizma të pushteteve në p/ligje, si dhe duhet të sqarohen përgjegjësitë e pushtetit të ekzekutivit dhe atij gjyqësor; c) Të mos bëhet shtimi i zyrave për ato fusha ku funksionojnë organet përkatëse.

Hajredin Kuçi theksoi se baza juridike e këtij P/ligji janë Korniza Kushtetuese dhe konventat ndërkombëtare të kësaj fushe. Ai propozoi që konventat ndërkombëtare të kësaj fushe t'i bashkangjiten si anekse Kornizës Kushtetuese. Në p/ligj ka shumë dispozita ideologjike e më pak dispozita juridike. Sipas këtij p/ligji është krijuar një konflikt ndërmjet Ombduspersonit dhe gjykatave.

Lilana Keniq tha se do ta kisha përkrahur këtë p/ligj nëse ndihmon në ndalimin e vrasjeve dhe të sulmeve ndaj serbëve. Vetë forma e shkruar e këtij p/ligji, sipas saj, është një diskriminim. Ky ligj nuk mund të zbatohet në praktikë.

Ramdan Kelmendi tha se në parim e përkrah këtë P/ligj. Barra e provave lidhur me diskriminimin bie mbi të paditurin që është e padrejtë. P/ligji duhet t'i parasheh edhe masat ndëshkimore për padinë e rreme lidhur me diskriminimin.

Sebahate Grajçevci tha se e përkrah në parim këtë p/ligj. Duhet të përfshihet edhe çështja e mosprivilegjimit të asnjë personi apo grupacioni. Mjetet e mbledhura nga gjobat duhen të derdhen në buxhetin e Kosovës, kurse Qendra për trajtim të barabart duhet të financohet nga Qeveria e Kosovës.

Xhavit Haliti tha se disa deputet të koalicionit "Kthimi" janë instrument të një politike që po bënë përpjekje të mbijetojë duke i akuzuar shqiptarët se po i sulmojnë dhe vrasin serbët mbi bazë nacionale. Një konstatim i tillë, shoi ai, nuk qëndron. Për vrasjet që kanë ndodhur në Kosovë, nuk duhet të fajësohet askush pa e thënë fjalën, në bazë të provave materiale, organet e drejtësisë.

Kuvendi dhe të gjitha institucionet e Kosovës janë deklaruar kundër çdo forme të diskriminimit apo vrasje që ka ndodhur.

Ai i luti përfaqësuesit e koalicionit "Kthimi" që ta harrojnë të kaluarën, kur në Kosovë ka pasur mëse gjashtëdhjetë mijë ushtarë dhe policë serb, gjyqësia dhe e tërë administrata e udhëhequr nga politika e Serbisë dhe është thënë se shqiptarët po i diskriminojnë serbët. Duhet të punojmë së bashku për ta miratuar legjislacionin e ri të Kosovës, në përputhje me standardet ndërkombëtare, për t'u inkuadruar sa më shpejtë në BE. Të mos vazhdohet me politikën e ndarjes dhe të akuzimeve.

Blerim Baruti tha se e përkrah këtë P/ligj në parim. Në p/ligj parashihet formimi i Qendrës për trajtim të barabartë, por të njejtin funksion e ushtron edhe Ombduspersoni.

Oliver Ivanoviq tha se një ligj që e rregullon çështjen e mosdiskriminimit është i nevojshëm, por ky çfarë e ka propozuar Qeveria, mënyra e koncipimit, pjesët e tij janë në kundërshtim me njëra tjetrën dhe si i tillë është i papranueshëm. Ai propozoi që ky p/ligj të tërhiqet nga procedura.

Nekibe Kelmendi tha se nuk është parimore kur një grup parlamentar thotë se nuk e përkrah një p/ligj dhe pastaj e keqpërdor foltorën për diskutim politik. P/ligjin duhet përkrahur, shtoi ajo, ngase jemi ngopur në të kaluarën me diskriminime. P/ligji duhet t'i përfshijë disa pjesë pjesë drejtpërsëdrejti të Konventës Ndërkombëtare kundër Diskriminimit.

Millovan Jovanoviq tha se asnjë ligj kundër diskriminimit nuk do të ndihmonte po që se shqiptarët nuk e kuptojnë se serbët si popull, nuk janë fajtorë për atë çka ju ka ndodhur në të kaluarën.

Këtu është qëllimi që me një ligj të improvizuar të zgjidhet çështja e diskriminimit. Është e qartë, sipas tij, se dispozitat e këtij p/ligji nuk mund të zbatohen.

Pas diskutimit, kryetari e vuri në votim këtë p/ligj dhe rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----shumica;

Kundër-----14;
Abstenime-----1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi i Kosovës e miratoi, në parim, P/ligjin kundër diskriminimit dhe i ngarkoi komisionet kryesore dhe Komisionin Funkcional ta shqyrtojnë p/ligjin brenda tri javësh dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportet dhe rekomandimet për miratim.

3. Shqyrtimi i propozimit për formimin e grupit të punës për përgatitjen e propozimeve për ndryshimin dhe plotësimin e Kornizës Kushtetuese.

Kryetari e ftoi kryetarin e Komisionit Legjislativ ta arsyetojë propozimin para deputetve.

Arsim Bajrami theksoi se kjo nismë ka bazueshmëri të plotë kushtetuese në vetë Kornizën kushtetuese, e cila në fakt e ka njohur të drejtën e këtij Kuvendi për të bërë ndryshime dhe plotësime përmes amendamenteve të Kornizës Kushtetuese.

Në anën tjetër, kjo nismë është plotësisht në frymën e vetë Kornizës kushtetuese, e cila në preambulë dhe në disa dispozita kalimtare, parasheh që përgjegjësitë do të barten hap pas hapi nga institucionet ndërkombëtare te institucionet vendore.

Kjo nismë nuk është një tendencë për të marrë përgjegjësitë njëanshëm nga ana e administratës ndërkombëtare, por është një ofertë shumë konstruktive që Kuvendi i Kosovës po ia bën UNMIK-ut për t'i marrë kompetencat dhe për t'i realizuar me sukses përgjegjësitë e përbashkëta.

Ai theksoi se është e domosdoshme një reformë kushtetuese ngase objektiva themelore e Kornizës Kushtetuese është realizuar. Objektive themelore e kësaj kornize ka qenë krijimi i bazës kushtetuese për ngritjen e institucioneve demokratike të Kosovës. Këto institucione janë ngritur dhe tani janë funksionale. Por, nuk është realizuar koncepti i vetëqeverisjes substanciale për Kosovën sipas Rezolutës 1244.

Me qëllim që të jetësohet qeverisja substanciale kuptimplote është më se e domosdoshme që t'i hyhet një reforme rrënjësore kushtetuese, në mënyrë që të ngriten dhe të forcohen kapacitetet qeverisëse të Kosovës.

Kjo reformë pretendon t'i arrijë tri qëllime kryesore: a) Të krijohet një bazë kushtetuese dhe ligjore për bartjen e përgjegjësi; b) Mundësitë e institucioneve të Kosovës për t'i përmbushur standardet ndërkombëtare para statusit final; c) T'i ndihmohet UNMIK-ut për ta finalizuar Rezolutën 1244, në përshpejtimin e zgjidhjes të statusit final.

Por, Kuvendi ka përgjegjësi të fillojë punën në hartimin e Kushtetutës së re të Kosovës, e cila do të jetë e gatshme në momentin kur do të rumbullaksohet çështja e implementimit të vullnetit politik të popullit të Kosovës

Kryetari e hapi diskutimin lidhur me këtë propozim.

Sabri Hamiti theksoi se Grupi parlamentar i LDK-së e përkrah nismën e Komisionit Legjislativ për ndryshimin dhe plotësimin e Kornizës Kushtetuese. Ai tha se grupi i punës

për përgatitjen e propozimeve duhet të ketë shtatë anëtarë dhe për anëtar të tij e propozoi deputeten Nekibe Kelmendi.

Dragisha Krstoviq tha se përfaqësuesit e koalicionit “Kthimi” në mbledhjen e Komisionit Legjislativ, kanë qenë kundër kësaj nisme. Sipas grupit Parlamentar “Kthimi”, së pari duhet të plotësohen standardet që i ka parashtruar PSSP-ja, pastaj mund të bëhen ndryshimet në Kornizën Kushtetuese.

Ramush Haradinaj theksoi se grupi i punës për përgatitjen e propozimeve për ndryshimin e Kornizës Kushtetuese, duhet të ketë parasysh të bëjë propozime për ndryshime thelbësore. Në ato ndryshime duhet të përfshihet edhe kompletimi i Qeverisë të Kosovës.

Faik Marolli tha se Grupi parlamentar i “komuniteteve e tjera” e përkrahë nismën për ndryshimet në Kornizën Kushtetuese, por kërkon që në anëtar i “komuniteteve e tjera” të jetë anëtar i grupit të punës për përgatitjen e propozimeve.

Hatixhe Hoxha e propozoi Hydajet Hysenin për anëtar të grupit të punës për përgatitjen e propozimeve për ndryshimin e Kornizës Kushtetuese.

Hasan Meta theksoi se nisma për ndryshimin e Kornizës Kushtetuese mund të jetë një vetëmashtrim, ngase ajo mund të mos përfillet nga KS i OKB-së. Ai tha se Kuvendi duhet të ndërmarrë hapa konkret për zgjidhjen e statusit të Kosovës në bazë premtimeve që i janë dhënë elektoratit dhe në bazë të së drejtës së popujve për vetëvendosje.

Bislim Hoti theksoi se e përkrah nismën për ndryshimin e Kornizës Kushtetuese dhe se këto ndryshime duhet t’u përgjigjen kërkesave të qytetarëve të Kosovës.

Hilmo Kandiç theksoi se e përkrah nismën për ndryshimin e Kornizës Kushtetuese dhe kërkoj që një anëtar nga “komunitete e tjera” të jetë në grupin e punës për propozimin e ndryshimeve.

Xhezair Murati tha se koha ka treguar se çdo akt juridik me kohë duhet të ndryshohet dhe t’i përshtatet jetës së qytetarëve. Ai propozoi që në grupin e punës, për përgatitjen e propozimeve, të përfshihet edhe një anëtar i komunitetit boshnjak dhe një i komunitetit turk.

Pas diskutimit për nismën e Komisionit Legjislativ për ndryshimin dhe plotësimin e Kornizës Kushtetuese, kryetari e vuri në votim atë dhe rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----shumica;
Kundër-----17;
Abstenime-----0.

Kryetari kosntatoi se Kuvendi i Kosovës e miratoi nismën e Komisionit Legjislativ për ndryshimin dhe plotësimin e Kornizës Kushtetuese.

Kuvendi e miratoi propozimin për formimin e grupit të punës për përgatitjen e propozimeve për ndryshimin dhe plotësimin e Kornizën Kushtetuese, në këtë përbërje:

1. Arsim Bajrami, kryetar,
2. Kolë Berisha, anëtar,
3. Fatmir Sejdiu, anëtar,
4. Bajram Kosumi, anëtar,
5. Dragisha Krstoviq, anëtar,
6. Nekibe Kelmendi, anëtare,
7. Hydajet Hyseni, anëtar dhe
8. Përfaqësuesi i “komiteteve e tjera”.

4. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare të datës 6 nëntor 2003.

Kuvendi, me propozim të Kryesisë, e miratoi rendin e ditës për seancën plenare të datës 6 nëntor, si vijon:

1. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit për inspektoratin sanitar-nr.2003.24;
2. Shqyrtimi i dytë i P.ligjit për pensionet e aftësisë të kufizuar-nr.2003/23;
3. Shqyrtimi i parë i P/ligjit për shëndetësi në Kosovë-nr.2003/31 dhe
4. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Çështje Gjyqësore, Legjislative dhe Kornizë Kushtetuese ,për emërimin e gjyqtarëve dhe prokurorve.

Seanca përfundoi në orën 12:20 minuta.

Sekretaria e Kuvendit

Kryetari i Kuvendit të Kosovës

akademik **Nexhat DACI**